



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

MIDIS

FAKULTETIT TË MJEKËSISË – UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA” (FM) DHE ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK)

Neni 1

Fakulteti i Mjekësisë dhe Oda e Stomatologëve të Kosovës (në vazhdim *Palët*) shprehin vullnetin dhe mirëkuptimin e tyre për një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe të domosdoshëm për rritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës profesionale të stomatologëve nëpërmjet formave të ndryshme të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (në vazhdim *EVP*).

Neni 2

Palët bien dakord të organizojnë aktivitete të përbashkëta në fushën e EVP, si: ligjërata, kongrese/konferenca, tubime shkencore, seminare, simpoziume, trajnime dhe forma të tjera të aktiviteteve, me qëllim të ngritjes profesionale të stomatologëve.

Neni 3

Palët bien dakord dhe mbështesin sistemin e krediteve të detyrueshme për stomatologët e sistemit publik dhe privat si parakusht për rilicensimin e tyre dhe ruajtjen e të drejtës për ushtrimin e profesionit.

Neni 4

Oda e Stomatologëve të Kosovës merr përsipër angazhimin për të njohur dhe për të akredituar format e ndryshme të aktiviteteve në kuadër të EVP, e që Fakulteti i Mjekësisë organizon dhe është bartës i tyre.

Fakulteti i Mjekësisë bashkëpunon dhe mbështet Oden e Stomatologëve të Kosovës për gjetjen e formave më efektive dhe më të mundëshme të EVP, në përputhje me kërkesat dhe nevojat konkrete të stomatologëve.

Neni 5

Palë zotohen të bashkëpunojnë në fushën e publikimeve dhe promovimit të shëndetit oral.

Neni 6

Palët zotohen të shqyrtojnë dhe aprovojnë projekte kërkimore të përbashkëta.

Neni 7

Palët zotohen të marrin pjesë në botime të përbashkëta profesionale dhe shkencore në Revistën e Stomatologëve të Kosovës.

Neni 8

Ky memorandum lidhen në afat të pacaktuar. *Palët* mund të bien dakord në çdo kohë për përfundimin e këtij memorandum.

Neni 9

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum zgjidhet me mirëkuptim mes *Palëve*.

Neni 10

Ky memorandum është lidhur në gjuhën shqipe dhe atë në 4 (katër) ekzemplar identik, nga 2 (dy) për secilën palë dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 05 qershor 2023

Për Fakultetin e Mjekësisë

Për Odën e Stomatologëve të Kosovës

Prof. Dr. Suzana Manxhuka-Kërliu

Prof. Dr. Blerim Kamberi

Dekane e Fakultetit të Mjekësisë

Kryetar i OSK-së

